



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË IEZHË

VENDIM

Nr. 128 datë 31.12.2019

**“PËR
RIPARIMIN E OBJEKTEVE NËPËRMJET NDËRHYRJEVE TË CILAT NUK
KËRKOJNË PAJISJE ME LEJE NDËRTIMI DHE DEKLARATË PARAPRAKE
PUNIMESH NË OBJEKTET E DËMTUARA SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS
26 NËNTOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30 dhe nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

V E N D O S I :

- 1- Kryerjen e procedurave për aplikimin pranë Bashkisë Lezhë për ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi dhe deklaratë paraprake për kryerje punimesh në objektet e dëmtuara si pasojë e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019.
- 2- Aplikimet për punimet që përfshihen në llojin e punimeve sipas nenit 6, të vendimit nr.408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për rregulloren e zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, kryhen nga pronari i objektit apo sipas autorizimit të lëshuar nga ky i fundit për sipërmarrësin që ka realizuar ndërtimin e këtij objekti.
- 3- Aplikimi për kryerjen e punimeve sipas përcaktimeve në këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi kryhet pranë Bashkisë Lezhë. Pjesë e pandashme e këtij aplikimi është edhe akti i ekspertizës i hartuar dhe i nënshkruar nga 3 inxhinierë ndërtimi të licensuar. Akti duhet të përmbajë dhe të përshkruajë llojin e ndërhyrjeve sipas parashikimeve të nenit 6 të vendimit nr. 408/2015, të ndryshuar.
- 4- Procedura për aplikimin e llojit të punimeve sipas pikës 2 të këtij vendimi do të mbajë dokumentacionin si më poshtë :
 - a) Akt ekspertimi/Relacion i nënshkruar nga 3 inxhinierë të licensuar dhe i miratuar nga Instituti i Ndërtimit, ku të jetë përcaktuar objekti i cili është subjekt i llojit të punimeve sipas nenit 6 të vendimit nr. 408/2015.
 - b) Fotokopje e licencës së inxhinierëve, brenda afatit të vlefshmërisë së saj.

- c) Dokumenti që vërteton pronësinë apo të drejtat e ligjshme të aplikuesit deklaruesit për pasurinë në të cilën do të kryhen punime, certifikatë pronësie, kontratë sipërmarrje/porosie, leje legalizimi apo vërtetimin që është në proces legalizimi, librezë uji apo energjie elektrike në emër të aplikuesit.
- 5- Aplikimi dhe dokumentacioni sipas këtij vendimi, dorëzohet pranë Bashkisë Lezhë brenda periudhës së kohëzgjatjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.
 - 6- Bashkia Lezhë shqyrton brenda ditës aplikimin e paraqitur dhe nëse aplikimi përfshihet në llojin e punimeve të parashikuara në nenin 6 të vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave, miraton kryerjen e punimeve.
 - 7- Bashkia Lezhë ndërpret çdo lloj shërbimi ndaj të gjithë atyre sipërmarrësve kur objektet e ndërtuara prej tyre kanë pësuar dëmtime dhe nuk paraqiten për riparimin e tyre dhe kthimin në gjendjen e mëparshme para rënies së tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
 - 8- Përgjigjja për miratimin e kryerjes së punimeve nënshkruhet nga Kryetari i Bashkisë.
 - 9- Aplikimet për punimet që përfshihen në llojin e punimeve sipas nenit 7 të vendimit nr.408/2015, do të vijojnë të kryhen sipas procedurave standarte për aplikimin për punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh në sistemin e-leje.
 - 10- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.
 - 11- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

